

Përmbledhje mbi të rejat më të fundit

Miratohet ligji nr.98/2020 datë 23.07.2020 për një ndryshim në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e Taksave Vendore”, të ndryshuar

Në mbështetje të neneve 78, 8, pika 1, 83, pika 1, 113, pika 1, shkronja “ç”, 155 dhe 157, pika 3, të Kushtetutës, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi që në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, të bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

- Në nenin 27, pika 3, shkronja c, fjalia “Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi” shfuqizohet.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratohet ligji nr.106/2020 për disa ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi që në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

- Në pikën 1 të nenit 16, “Fusha e veprimit të tatimit mbi fitimin”
 - Shkronja “a” riformulohet: “Personat juridik dhe ortakëritë e parashikuara në nënparagrafët "iii" dhe "iv" të shkronjës "b" të pikës 1 të nenit 2 me të ardhura mbi 8 000 000 lekë në vit”.
 - Shkronja “a” riformulohet: “Çdo person tjetër, pavarësisht nga statusi ose forma ligjore e regjistrimit apo e njohjes së tij, me përjashtim të rastit kur ky person është subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël”.
- Pika 1 e nenit 28, shkalla e tatimit mbi fitimin është:
 - a) 0% për tatimpaguesit me të ardhura deri në 14 000 000 lekë në vit.
 - b) 15% për tatimpaguesit me të ardhura mbi 14 000 000 lekë në vit.

Miratohet ligji nr. 108/2020 për një ndryshim në ligjin nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi që pika 2 e nenit 48 të ligjit nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit” ndryshohet si më poshtë:

“Përjashtimisht pikës 1 të këtij neni, në varësi të llojit të transaksionit, ky ligj i fillon efektet sipas grafikut të përcaktuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të kësaj pike:

- a) për transaksionet pa para në dorë ndërmjet tatimpaguesve dhe organeve publike, efektet e këtij ligji fillojnë më 1 janar 2021.
- b) për transaksionet pa para në dorë ndërmjet tatimpaguesve, efektet e këtij ligji fillojnë më 1 korrik 2021.
- c) për transaksionet me para në dorë nga tatimpaguesit, pavarësisht përgjegjësisë tatimore apo qarkullimit vjetor të realizuar, efektet e këtij ligji fillojnë më 1 shtator 2021.”

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratohet ligji nr. 109/2020 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.4/2020, “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 e Kushtetutës, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi që në ligjin nr. 4/2020, “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Në nenin 11 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:
“Përgjashtimisht për shkëmbimin e parë automatik, autoriteti kompetent shkëmben informacion me juridiksionet e tjera kompetente brenda datës 31.12.2020.”.
- Pika 1 e nenit 19 ndryshohet si më poshtë:
“Përgjashtimisht për raportimin e parë, institucioni financiar raportues, pas aplikimit të procedurave të vigjilencës së duhur, raporton brenda datës 15 nëntor 2020 për të gjitha llogaritë e raportueshme ekzistuese në datën 1.1.2019, si dhe llogaritë e raportueshme të hapura përgjatë vitit 2019, sipas detyrimit të përcaktuar në nenin 6 të këtij ligji.”

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare

Miratohet ligji 110/2020 datë 29.7.2020 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi që në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Në fund të nënndarjes “ii” të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 122 shtohet fjalia me këtë përmbajtje: “Masa e bllokimit të veprimtarisë hiqet para afatit 30-ditor nëse tatimpaguesi paguan dënimin sipas këtij paragrafi”.

- Në kreun XV, pas pikës 5 të nenit “Dispozita kalimtare” shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:
“Pajisjet fiskale, të ofruara nga shoqëritë e autorizuar, me të cilat janë pajisur tatimpaguesit para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vijojnë të funksionojnë dhe të mirëmbahen nga këto shoqëri për aq sa nuk bien në kundërshtim me ligjin nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”. Deri në datën e fillimit të efekteve juridike, sipas nenit 48 të ligjit nr. 87/2019, shoqëritë që kanë qenë të autorizuar, sipas vendimit nr.781, datë 14.11.2007, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe iu ka përfunduar afati i autorizimit përpara apo gjatë periudhës kalimtare, vazhdojnë të ofrojnë shërbimin e mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale për tatimpaguesit. Përcaktimet e këtij paragrafi nuk përjashtojnë përmbushjen e detyrimeve sipas ligjit nr. 87/2019.”
- Pika 3 e nenit 136 “Shfuqizime” riformulohet si më poshtë:
“Në momentin e shfuqizimit të neneve 55 dhe 56 të këtij ligji, shfuqizohen udhëzimi nr. 16, datë 3.5.2010, i Ministrit të Financave, “Për administrimin dhe dokumentimin e procedurave të pajisjeve fiskale”, vendimi nr. 781, datë 14.11.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për karakteristikat teknike e funksionale të pajisjeve fiskale, sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike, të deklarimeve financiare, sistemit të komunikimit, për procedurën e dokumentacionin për miratimin e tyre dhe për kriteret për pajisjen, me autorizim, të shoqërive të autorizuar për ofrimin e pajisjeve fiskale”, i ndryshuar, dhe dispozitat e tjera të ligjeve zbatuese të nxjerra në zbatim të këtij ligji, të cilat janë në kundërshtim me këtë ligj”.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Udhëzim Nr. 32, datë 25.8.2020 për një ndryshim në Udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë, udhëzon që në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të bëhet ky ndryshim:

Në nenin 55 “Kufizime të zbritjes së TVSH-së për disa furnizime”, paragrafi “II.TRANSPORT”, gërma “a) Transport udhëtarësh”, togfjalëshi “deri më 43 %”, bëhet “deri më 100 %”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

Udhëzimi nr. 29, datë 28.7.2020 për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 28, datë 31.12.2012, të Ministrit të Financave “Për metodat dhe procedurat e raportimit dhe marrjes së masave parandaluese nga subjektet e ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar”

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 28, pika 3, të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, Ministri i Financave dhe Ekonomisë udhëzon që në udhëzimin nr. 28, datë 31.12.2012, të ministrit të Financave “Për metodat dhe procedurat e raportimit dhe marrjes së masave parandaluese nga subjektet e ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 ‘Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit’, të ndryshuar”, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

- Pika 4 e nenit 3 zëvendësohet me këtë përmbajtje, “Për organizimet ligjore: identifikimin e themeluesit, të përfituesit, të kujdestarit ose të personit që ushtron kontroll faktik mbi to, sipas të dhënave të parashikuara në shkronjat e mësipërme, në varësi të faktit nëse është person fizik ose person juridik privat”.
- Neni 10 ndryshohet si më poshtë vijon:
 1. Subjektet, veprimtaritë e të cilëve përfshijnë transferta parash ose vlerash, duhet të sigurohen që transfertat ndërkufitare elektronike të jenë të shoqëruara gjithnjë me të dhëna si më poshtë:
 - a. Informacion i kërkuar dhe i saktë për dërguesin:

- i. emrin dhe mbiemrin e dërguesit kur është individ;
 - ii. emërtimin, kur dërguesi është person juridik;
 - iii. numrin e llogarisë së dërguesit kur një llogari e tillë përdoret për të përpunuar transaksionin ose, në mungesë të një llogarie, një numër unik të referencës së transaksionit që lejon gjurmueshmërinë e transaksionit;
 - iv. adresën e dërguesit ose numrin e identitetit kombëtar, ose numrin e identifikimit të klientit ose datën dhe vendin e lindjes.
 - b. Informacioni i kërkuar për përfituesin:
 - i. emrin dhe mbiemrin e përfituesit;
 - ii. emërtimin, kur përfituesi është person juridik;
 - iii. numrin e llogarisë së përfituesit kur një llogari e tillë përdoret për të përpunuar transaksionin ose, në mungesë të një llogarie, një numër unik të referencës së transaksionit që lejon gjurmueshmërinë e transaksionit.
2. Subjektet marrin masat e tjera sipas parashikimeve të nenit 10, të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar
- Pika 3 e nenit 11 ndryshohet si më poshtë: “Formulari (RAD) duhet të shoqërohet me të gjithë informacionin e nevojshëm, që mbështet dyshimet e parashtruara në raport, si dhe lejon nxjerrjen e konkluzioneve përkatëse, si: analizën e kryer, nxjerrjen e llogarisë bankare, dokumentet e identifikimit, të dhënat e transfertave, kontratat etj., dhe dërgohet i plotë në rrugë elektronike, si dhe me shkresë zyrtare nëse raportimi elektronik është objektivisht i pamundur. Raportimi në rrugë elektronike, kryhet bazuar standardet, formatin dhe aksesin që autoriteti

përgjegjës u siguron sipas kërkesës së bërë për këtë qëllim nga subjekti.”

- Në fund të pikës 1 të nenit 12 shtohet fjalia me këtë përmbajtje: “Nga ky detyrim përjashtohen transaksionet që kryhen me organet apo ndërmarrjet publike.”

Për të lexuar të gjitha ndryshimet dhe anekset, klikoni në linkun e mëposhtëm:

https://qbz.gov.al/alfresco/api/-default-/public/alfresco/versions/1/nodes/64dadd52-9ec0-40a6-9017-18fe247ba9db/content?attachment=false&alf_ticket=TICKET_8438c35c09f7494494754e02839d190bf407235e

Miratohet vendimi nr. 613, datë 29.7.2020 për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 4/2020, “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18, të ligjit nr. 4/2020, “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave vendosi dispozitat e përgjithshme, kërkesat e raportimit dhe e vigjilencës së duhur. Ky vendim parashikon rregullat dhe procedurat për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare. Standardi i raportimit të përbashkët dhe komentaret e tij, të miratuar nga Këshilli i Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, më 15 korrik 2014, të ndryshuar, do të aplikohen për qëllim të interpretimit të këtij vendimi.

Për të lexuar vendimin e plotë, klikoni në linkun e mëposhtëm.

https://qbz.gov.al/alfresco/api/-default-/public/alfresco/versions/1/nodes/0cc45fd0-d020-4883-9c31-36dd1f46e16f/content?attachment=false&alf_ticket=TICKET_8438c35c09f7494494754e02839d190bf407235e